



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 37/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.01.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “CURRI” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion dhe Instalim i Sistemit të ngrohjes në Shkollën e mesme “Ismail Qemali”, me nr. REF-35140-11-21-2017, me fond limit 109,796,282 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.12.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Kronos Konstruksion” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap. 3, Njësia Bashkiake Nr.10, Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Tiranë.
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd.2, kodi postar 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 22.11.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion dhe Instalim i Sistemit të ngrohjes në Shkollën e mesme “Ismail Qemali”, me nr. REF-35140-11-21-2017, me fond limit 109,796,282 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.12.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

II.2 Në datën 15.12.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3.Në datën 19.12.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "INERT" sh.p.k.	81,296,840 lekë pa tvsh Skualifikuar;
2. "Kola Invest" sh.p.k. & "Igor Elektrik" sh.p.k.	84,430,490 lekë pa tvsh Skualifikuar;
3. "Klajger Konstruksion" & "VARAKU-E" sh.p.k.	91,444,698 lekë pa tvsh Skualifikuar;
4. "CURRI" sh.p.k.	93,092,078 lekë pa tvsh Skualifikuar;
5. "S.A.G" & "Viante Konstruksion" sh.p.k.	96,933,134 lekë pa tvsh Skualifikuar;
6. "Kronos Konstruksion" & "EVEREST" sh.p.k.	100,985,475 lekë pa tvsh Kualifikuar;
7. "AERTERMIKA" sh.p.k.	101,985,475 lekë pa tvsh Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "CURRI" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsytet si më poshtë vijon:

"Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

• AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë: - Një punësim mesatar i të paktën 90 (nentedhete) personave, për periudhën Tetor 2016 - Tetor 2017; - Shoqëria "CURRI" shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore(sistemi) me Nr. T00056761 datë 14.12.2017 si dhe në list pagesat për periudhën Tetor 2016- Tetor 2017 rezulton të ketë një numër mesatar prej 172 punonjësish. Ndërkohë shoqëria "Curri" shpk është kualifikuar në vend të parë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, për procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Infrastrukturës rrugore të Bllokut të Kufizuar nga rrugët "Zogu i I-rërruga e Dibrës"- "Siri Kodra" dhe "Reshit Petrela" (kontrata lidhur më datë 27.09.2017 me afat të kryerjes së punimeve 7 muaj kalendarik dhe nr prot 14800/7), ku numri mesatar i punonjësve të kërkuar për realizimin e objektit të mësipërm është 90 punonjës dhe shoqëria Curri shpk ka të angashuar 90 punonjës, Shoqëria "Curri" shpk aktualisht ka të angazhuar 90 punonjës në objektet e sipërcituara. Në objektin "Rikonstruksion dhe Instalim i Sistemit të ngrohjes në Shkollën e mesme "Ismail Qemali", duhet të angazhojë 90 punonjës të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit.Nga faktet e paraqitur më sipër del se shoqëria "CURRI" shpk ka të punësuar për periudhën Tetor 2016- Tetor 2017 një numër mesatar prej 172 punonjësish gjithashtu ka të angazhuar në objektin e mësipërme një numër prej 90 punonjësish, në këtë mënyrë shoqërisë nuk e plotëson kriterin e mësipërm pasi i mbeten disponibël vetëm 82 punonjës për tu angazhuar në objektin "Rikonstruksion dhe Instalim i Sistemit të ngrohjes në Shkollën e mesme "Ismail Qemali" ndërkohë që në dokumentat e tenderit numri i punonjësve të kërkuar është 90 punonjës. Pra sa më sipër shoqëria CURRI

shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/i, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme..... b) Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

• Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9) mjetet sasia gjendja kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10(dhjete) ton për secilin kamion) 3 copë pronësi ose me qera fadrome me goma 1 copë pronësi ose me qera motogjenerator 1 copë pronësi ose me qera eskavator me goma 0.25 m3 2 copë pronësi ose me qera kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton 3 copë pronësi ose me qera autobetoniere 2 copë pronësi ose me qera mini eskavator 1 copë pronësi ose me qera betonforma 500 m2 pronësi ose me qera matrapik 2 cope pronësi ose me qera vibrator 2 copë pronësi ose me qera kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion) 4 cope pronësi ose me qera autopompe betoni 1 copë pronësi ose me qera depozitë uji (5000) 1 copë pronësi ose me qera skela metalike (forme h) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë) 1500 m2 pronësi ose me qera autobot uji 1 copë pronësi ose me qera auto vinç 1 copë pronësi ose me qera a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes. b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre. c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese). f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me

qellim verifikimi). g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 11.12.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë. Operatori Ekonomik "CURRI" shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.9 se disponon mjetet e mëposhtëme: Autovinç me kosh TR7409 S i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës ELALCOM shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Vinç për montimet e shtyllave me targë TR 3415 R i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës ELALCOM shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë KR7093 i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës ELALCOM shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë KR7093 i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë AA562 AD i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë AA0450V i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë KR8096A i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë AA276EN i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë KR6381A i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targë KR6998A i siguar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobot me targë

TR9983R i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamionçinë me targë AA701MP i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamionçinë me targë TR4553S i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobetonierë me targë TR6489N i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobetonierë me targë TR 0748 S i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobetonierë me targë TR1068N i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobpompë betoni me targë TR5857Li i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autopompë betoni me targë TR6371P i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës BABASI CO shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobot me targë TR9983R i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës MELA shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamionçinë me targë AA701MP i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës MELA shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamionçinë me targë TR4553S i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës MELA shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Theksojmë se autobotin e mësipërm dhe dy kamionçinat i keni deklaruar në shtojcë sikur i keni siguruar me dy shoqëri të ndryshme (të njëjtët mjete) siguruar me BABASI dhe herës tjetër me MELA shpk Kamion Man me targa TR 8527 T i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion me targa TR 2639 S i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9

por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Kamion Man me targa TR AA310 PI i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobetonierë me targa ACMT 95 i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Autobot uji me targa TR 3368 N i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Fadromë Volvo me targa ACMT86 i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Eskavator me goma i siguruar me kontratë qeraje me qeradhënës Shpresa Al shpk por vihet re se ky mjet është paraqitur në shtojcën 9 por nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik të app-së nuk rezulton që shoqëria të ketë të paraqitur dokumentacion për këtë mjet. Përsa u përket mjeteve të siguruara dhe të pasqyruara në shtojcë nga shoqëria CURRI shpk për të cilët shoqëria ka paraqitur dhe dokumentacion në sistemin elektronik të app-së sqarojmë se shoqëria për të vërtetuar disponimin e mjeteve me kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10(dhjetë) ton për secilin kamion si dhe (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pikë pesë) ton dhe maksimumii 5(pesë) ton për secilin kamion) ka paraqitur si më poshtë :

1. Kamion me targa AA207NO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 384 T
2. Kamion me targa AA213NO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25 Ton
3. Kamion me targa AA210 NO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 23Ton
4. Tërheqës me targa TR9997T për të cilin nuk kanë paraqitur rimorkio nga ku Autoriteti të nxjerrë kapacitetin mbajtës.
5. Kamion me vinç me targa TR6876K me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
6. Kamion me targa AA934BJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.6 Ton
7. Kamion me targa AA517HY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.4 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
8. Kamion me targa AA789 EB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomikë nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnje kamion vetëshkarkues pasi Kamionet e e deklaruara nga operatori ekonomik kanë kapacitetin mbajtës mbi 10 ton dhe poshtë 3.5 ton . Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me

shtojcën 9 , është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton te kerkuar nga AK (4 cope) , për rrjedhojë i pavlefshëm

• AK në dokumentat Standarte te Tenderit/Kapaciteti Teknik për realizimin e kontratës ka kërkuar si më poshtë: 5.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për te pakten gjashtë muajt e fundit 31 (tridhjetë e nje) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten: - Kategori I- 7(shtate) punonjës - Kategori II-10 (dhjetë) punonjës - Kategori III- 9(nëntë) punonjës - Kategori IV-3 (tre) punonjës - Kategori V- 2 (dy) punonjës) - (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) Operatori ekonomik i mesiperm ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri punonjes me kategori te I, II, V sakte por nuk ka paraqitur punonjesit e kerkuar nga AK, ne dokumentat e tenderit per kategorine e trete dhe te katert . Konkretisht shoqeria CURRI shpk ka paraqitur vetëm dy punonjës me kategori të tretë nga 9 të kërkuar dhe përkatësisht punonjësit me iniciale L.P dhe F.C, gjithashtu Operatori ekonomik i mesiperm ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri vetëm dy punonjës me kategori të katërt nga 3 të kërkuar dhe përkatësisht punonjësit me iniciale A.K dhe Z.K Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. ”

II.4.Në datën 22.12.2017 operatori ekonomik ankimues ”CURRI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe ngre pretendime lidhur me kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Kronos Konstruktion” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Aresyetimi i KVO, ne kete skualifikim te bere eshte shume i çuditeshme, po ashtu edhe aritmetika e perdorur ne kete arseyetim, por njekohesisht eshte edhe per te qeshur. Nje „HALL“ shume i madhe do t’ju detyronte te benit ne menyre rrufe vleresimin ne date 18 Dhejtor, te procedures se zhvilluar ne date 15 Dhjetor. Po ky „HALL“ i madhe ju ka detyruar te sajoni aritmetika te tilla absurde. Po eshte e vertet qe ne kemi lidhur nje

kontarte dhe jemi ne realizim e siper me Bashkine Tirane me objekt: “Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të Bllokut të Kufizuar nga rrugët “Zogu i I rruga e Dibrës”-“Siri Kodra” dhe “Reshit Petrela”. Por, ju gaboni me aritmetiken tuaj Profane. Kriteri ne DST, ka qene si me poshte: 1. Nje punësim mesatar i të paktën 90 (nëntëdhjetë) personave, për periudhën Qershor 2016 Qershor 2017, të vërtetuar me;

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Qershor 2016 -Qershor 2017.

b. List-pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2016 -Qershor 2017 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Por ky eshte thjeshte nje kriter kualifikimi dhe jo detyrim per te punesuar ne kontraten e lidhur 90 punonjes. Kriteri i referohet edhe vitit 2016. A shtrihet kontrata ne qe kemi lidhur ne vitin 2016????? Jo, kontrata eshte lidhur më datë 27.09.2017 me afat të kryerjes së punimeve 7 muaj kalendarik. Edhe ne DST e procedures aktuale per te cilen ankohemi kerkesa juaj eshte per nje numur mesatar punonjesish Tetor 2016- Tetor 2017, por jo per te punesuar 90 punonjes ne realizimin e kesaj kontrate. Nese do te ndodhte keshtu kompanite e ndertimit nuk do te kishin fare eficence ne pune. Percaktimi i numrit te punonjesve, behet mbi bazen e volumeve te punimeve te parashikuara dhe per kete ka nje llogaritje mbi bazen e Manualit dhe Kushteve Teknike Zbatimit. Ne do t’ju bejme kete llogaritje dhe do t’ua veme ne dispozicion ne shkallen tjetër te ankimit ne KKP. Prandaj eshte edhe ajo kohezgjatja e kontrtes 7 muaj apo 10 muaj ne rastin tone.

Shpjegime: Eshte absurd klasifikimi qe keni bere per kamionat dhe kamioncinat. Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor, ka vetem kete klasifikim per kamionat:

Kamion deri ne 3.5 ton qe jane kamioncina

Kamion nga 3.5 ton deri ne 7.5 ton

Kamion nga 7.5 ton deri ne 18 ton

Kamion mbi 18 ton

Nuk e dime ku e keni gjetur ju klasifikimin qe keni bere ne DST. Ju duhet te dini, por edhe mund ta mesoni duke pare thjeshte dokumentete e tenderit, automjetet Kamioncina, kane te shenuar ne lejen e qarkullimit ATP qe do te thote Automjet i Transportit te Posaçem, pra nuk mund ta beni ndarjen si te deshironi Ju. Me kontrata qiraje dhe mjete ne pronesi, ne kemi paraqitur ne kete procedure prokurimi automjetet e kerkuara:

Kamioncine: Mjeti me targe AA395OS

Kamioncine: Mjeti me targe KJ7435A

Kamioncine: Mjeti me targe AA648BZ

Kamioncine: Mjeti me targe AA918HP

Kamioncine: Mjeti me targe AA 169SK

Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA934BJ

Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA517HY

Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA789EB

Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA207NO

Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA213NO

Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA210NO

Terheqes: Mjeti me targe TR9997T

Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR330

Terheqes: Mjeti me targe: AA715MH

Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR298

Terheqes: Mjeti me targe: AA256LJ

Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR297

Terheqes: Mjeti me targa AA934MS

Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR326

Pra ne total, ne perputhje me DST per ekzekutimin e kesaj kontrate kemi vendsour ne dispozicion 5 Kamioncina dhe 10 kamiona apo automjete vetshkarkuese.

KJO ARESYE SKUALIFIKIMI NUK I QENDRON DHE ESHTË NE KUNDERSHTIM ME PERCAKTIMET LIGJORE NE FUSHEN E TRANSPORTEVE

Shpjegime: Nuk kuptojme, aresyen se pse autoriteti kontraktor ka percaktuar edhe katergorine e specialisteve qe duhet te kete operatori ekonomik. Pamvaresisht kategorise qe mund te kene specialistet, ashtu sikurse edhe tanet i kane, pergjegjes per realizimin sipas kerkesave teknike dhe projektit te kontrates eshte shoqeria ofertuese, apo operatori ekonomik. Ne kemi paraqitur ne kete procedure prokurimi, stafin tone teknik te kualifikuar, te çerifikuar me librezat perkatese dhe te rregjistruar dhe deklaruar ne organet tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore.

KJO ARESYE SKUALIFIKIMI NUK QENDRON, DHE KY KRITER ESHTË NE KUNDERSHTIM ME PARIMET E LIGJIT TE PROKURIMIT PUBLIK. KY KRITER ZVOGELON KONKURENCEN E OPERATOREVE EKONOMIKE.

Duam tju bejme me dije se, ne jemi nje kompani qe operojme prej me shume se 20 vitesh ne tregun e ndertimit dhe rikonstruksionit te objketeve civile dhe industriale dhe infrastruktures inxhinierike. Ne kete pozicion, njohim mire dhe konkurentet tane te ndyshem, dhe shpesh here edhe bashkepunojme me ata. Ne kete kuader, ne dijenine tone shoqeria „KRONOS KONSTRUKSION“ Sh.pk, nuk ka asnje objekt te ngjashem ne fushen e rikonstruksionit dhe ndertimit te objketeve civile e sociale. Po edhe kjo do ti perkase, hapit tjeter te ankeses ne KPP ku do te kerkojme shqyrtimin nga KPP te dokumentacionit te kompanise se vetme te kualifikuar ne kete procedure prokurimi. Ju e keni klasifikuar ate kompani si fituese dhe keni skualifikuar oferten tone me me aresye absurde qe permendem me siper. Por, njekohesisht ju si KVO dhe autoritet kontraktor jeni duke shkaktuar nje dem ekonomik me perdorimin e fondeve publike pasi vetem po te krahasoni diferencen e kesaj oferte me tone demi ekonomik eshte 8.000.000 leke te reja. Po ta krahasoni me oferten me te ulet ne kete procedure prokurimi demi ekonomik shkon ne 20.000.000 leke te reja. [...]

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 46241/2 Prot. datë 22.12.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "CURRI" sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura prej tij.

II.6. Në datën 28.12.2017 pala ankimuese operatori ekonomik ankimues "CURRI" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7. Në datën 05.01.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.138/1prot., datë 04.01.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "CURRI" sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin "Eshte absurd klasifikimi qe keni bere per kamionat dhe kamioncinat. Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor, ka vetem kete klasifikim per kamionat: Kamion deri ne 3.5 ton qe jane kamioncina Kamion nga 3.5 ton deri ne 7.5 ton Kamion nga 7.5 ton deri ne 18 ton Kamion mbi 18 ton. Nuk e dime ku e keni gjetur ju klasifikimin qe keni bere ne DST. Ju duhet te dini, por edhe mund ta mesoni duke pare thjeshte dokumentete e tenderit, automjetet Kamioncina, kane te shenuar ne lejen e qarkullimit ATP qe do te thote Automjet i Transportit te Posaqem, pra nuk mund ta beni ndarjen si te deshironi Ju. Me kontrata qiraje dhe mjete ne pronesi, ne kemi paraqitur ne kete procedure prokurimi automjetet e kerkuara: Kamioncine: Mjeti me targe AA395OS Kamioncine: Mjeti me targe KJ7435A Kamioncine: Mjeti me targe AA648BZ Kamioncine: Mjeti me targe AA918HP Kamioncine: Mjeti me targe AA 169SK Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA934BJ Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA517HY Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA789EB Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA207NO Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA213NO Kamion vetshkarkues: Mjeti me targe AA210NO Terheqes: Mjeti me targe TR9997T Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR330 Terheqes: Mjeti me targe: AA715MHGjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR298 Terheqes: Mjeti me targe: AA256LJ Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR297 Terheqes: Mjeti me targa AA934MS Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targe ADR326 Pra ne total, ne perputhje me DST per ekzekutimin e kesaj kontrate kemi vendsour ne dispozicion 5 Kamioncina dhe 10 kamiona apo automjete vetshkarkuese. KJO ARESYE SKUALIFIKIMI

NUK I QENDRON DHE ESHTË NE KUNDERSHTIM ME PERCAKTIMET LIGJORE NE FUSHEN E TRANSPORTEVE ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 3.12 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

-Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtësminimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion), 3 copë, Pronësi ose me qera.

-Fadrome me goma, 1 copë, Pronësi ose me qera

-MotoGjenerator, 1 copë, Pronësi ose me qera

-Eskavator me goma 0.25 m3, 2 copë, Pronësi ose me qera

-Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton, 3 copë, Pronësi ose me qera

-Autobetoniere, 2 copë, Pronësi ose me qera

-Mini eskavator, 1 copë, Pronësi ose me qera

-Betonforma, 500 m2, Pronësi ose me qera

-Matrapik, 2 cope, Pronësi ose me qera

-Vibrator, 2 copë, Pronësi ose me qera

-Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion), 4 cope, Pronësi ose me qera

-Autopompe betony, 1 copë, Pronësi ose me qera

-Depozitë uji (5000), 1 copë, Pronësi ose me qera

-Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë,)1500 m2, Pronësi ose me qera

-Autobot uji, 1 copë, Pronësi ose me qera

-Auto vinç, 1copë, Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 copë

- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë

- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te

shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 11.12.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.”

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues, “CURRI” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë Qiraje nr.655rep, nr.95kol, datë 14.12.2017, lidhur ndërmjet I.S. (Qiradhënës) dhe ”CURRI” sh.p.k (Qiramarrës), objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e Kamionit me targë AA934BJ dhe Kamioncinës me targë AA648BZ, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Kontratë Qiraje nr.654rep, nr.94kol, datë 14.12.2017, lidhur ndërmjet R.T. (Qiradhënës) dhe ”CURRI” sh.p.k (Qiramarrës), objekt i kësaj kontrate, ndër të tjera, është dhënia me qira e Kamionit me targë AA517HY, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Kontratë Qiraje nr.657rep, nr.97kol, datë 14.12.2017, lidhur ndërmjet “VAGALAT” sh.p.k. (Qiradhënës) dhe ”CURRI” sh.p.k (Qiramarrës), objekt i kësaj kontrate, ndër të tjera, është dhënia me qira e dhe Kamioncinave me targë AA918HP; AA169SK dhe Kamionëve me targë AA807NO; AA213NO; AA210NO, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

4. Kontratë Qiraje nr.656rep, nr.96kol, datë 14.12.2017, lidhur ndërmjet “SAT KONSTRUKSION” sh.p.k. (Qiradhënës) dhe ”CURRI” sh.p.k (Qiramarrës), objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e Kamionit me targë AA789EB dhe Kamioncinës me targë KJ7435A, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
5. Dokumentacioni për mjetin tip ATP, në pronësi të “CURRI” sh.p.k., me targë. AA395OS, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*
b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose 6*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, përkatësisht shtojcën 9 “Mbi disponimin e makinerive e pajisjeve”, me anë të së cilës operatori ekonomik ankimes deklaroi se zotëron mjetet dhe pajisjet teknike për të realizuar kontratën objekt prokurimi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për kamionat dhe kamioncinat, referuar dokumentit leje e qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat

e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i tij, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg), evidentohet si më poshtë:

- Për mjetin me targë AA934BJ, kapaciteti mbajtës = 1.4 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë AA648BZ, kapaciteti mbajtës = 1.25 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë AA395OS, kapaciteti mbajtës = 0.9 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë AA918HP, kapaciteti mbajtës = 1.4 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë AA169SK, kapaciteti mbajtës = 1 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë AA934BJ, kapaciteti mbajtës = 1.4 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë KJ7435A, kapaciteti mbajtës = 1.36 ton (më pak se 3.5 ton).
- Për mjetin me targë AA517HY, kapaciteti mbajtës = 5.46 ton (më shumë se 5 ton).
- Për mjetin me targë AA207NO, kapaciteti mbajtës = mbi 18 ton (më shumë se 5 ton).
- Për mjetin me targë AA213NO, kapaciteti mbajtës = 25 ton (më shumë se 5 ton).
- Për mjetin me targë AA210NO, kapaciteti mbajtës = 23.6 ton (më shumë se 5 ton).
- Për mjetin me targë AA789EB, kapaciteti mbajtës = 8.5 ton (më shumë se 5 ton).

III.1.7.KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur dokumentacion provues për mjetet e deklaruar në shtojcën 9 mbi disponimin e mjeteve, përkatësisht mjetet sipas kontratës së qirasë nr.20rep., nr.13.kol, datë 14.02.2017; kontratës së qirasë nr.23rep., nr.16.kol, datë 18.02.2017; me qiradhënës “BABASI & CO” sh.p.k. kontratës së qirasë nr.23rep., nr.16.kol, datë 18.02.2017; me qiradhënës “MELA” sh.p.k. dhe kontratës së qirasë nr.2120rep., nr.660.kol, datë 05.09.2017 me qiradhënës “Shpresa AI” sh.p.k. Gjithashtu, konstatohet se mjetet e pretenduara nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targë ADR330 Terheqes: Mjeti me targë: AA715MHG Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targë ADR298 Terheqes: Mjeti me targë: AA256LJ Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targë ADR297 Terheqes: Mjeti me targë AA934MS Gjysem rimorkio veteshkarkim: mjeti me targë ADR326”, nuk rezultojnë të pasqyruara në shtojcën 9 mbi disponimin e mjeteve, sikurse është kërkuar në mënyrë eksplicite nga autoriteti kontraktor në pikën 3.12 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, të dokumentave standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)”, duke e privuar autoritetin kontraktor për të kryer verifikimet e nevojshme mbi këto mjete.

III.1.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e 4 mjeteve kamion 3.5-5 ton. Konstatohet se, asnjë nga mjetet e deklaruar nga operatori ekonomik si kamion apo kamioncinë në shtojcën 9, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, plotëson këtë

kapacitet përsa i përket kapacitetit mbajtës së parashikuar nga autoriteti në DST. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi, referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të plotësohet tonazhi i kërkuar i mjeteve, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 3.12 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, ndërkohë që vetëm një nga mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues i përmbushë kushtet e kriterit.

III.1.9. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.10. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve

kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “CURRI” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “*Shpjegime: Nuk kuptojme, aresyen se pse autoriteti kontraktor ka percaktuar edhe kategoriale dhe specialisteve qe duhet te kete operatori ekonomik. Pamvaresisht kategorise qe mund te kene specialistet, ashtu sikurse edhe tanet i kane, pergjegjes per realizimin sipas kerkesave teknike dhe projektit te kontrates eshte shoqeria ofertuese, apo operatori ekonomik. Ne kemi paraqitur ne kete procedure prokurimi, stafin tone teknik te kualifikuar, te çertifikuar me librezat perkatese dhe te rregjistruar dhe deklaruar ne organet tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore. KJO ARESYE SKUALIFIKIMI NUK QENDRON, DHE KY KRITER ESHTË NE KUNDERSHTIM ME PARIMET E LIGJIT TE PROKURIMIT PUBLIK. KY KRITER ZVOGELON KONKURENCEN E OPERATOREVE EKONOMIKE.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në pikën 3.5.1 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“*Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për te paktën gjashtë muajt e fundit 31 (tridhjetë e nje) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te paktën:*

- *Kategori I- 7(shtate) punonjës*
- *Kategori II-10 (dhjetë) punonjës*
- *Kategori III- 9(nëntë) punonjës*
- *Kategori IV-3 (tre) punonjës*
- *Kategori V- 2 (dy) punonjës*

- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)
- Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë te punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda ng ate cilet dy automakiniste dhe dy eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.”

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje e kriterit “Kategori III- 9(nëntë) punonjës”, operatori ekonomik ankimues, “CURRI” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nr.002724, lëshuar nga TCPE, për F.C.
2. Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nr.002728, lëshuar nga TCPE, për L.P.

III.2.3.Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

III.2.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.2.5.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumntacion provues që disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të kategorisë (grupi) III vetëm për 2 (dy) punonjës. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se autoriteti kontraktor, në pikën 3.5.1 të shtojcës 10, “Kapaciteti Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka kërkuar në mënyrë eksplicite se operatori ekonomik duhet të provojë se ka të punësuar 9 (nëntë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të kategorisë (grupi) III. Vlen të theksohet se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti

kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Për këto arsye, KPP gjykon se ndodhemi para faktit që operatori ekonomik ankimues nuk arrin të provojë se ka të punësuar 9 (nëntë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të kategorisë (grupi) III, e për rrjedhojë nuk e përmbush kriterin e sipërcituar të vendosur nga autoriteti kontraktor.

III.2.6. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i

Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për të skualifikuar e ofertën e operatorit ekonomik “Kronos Konstruksion” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues “CURRI” sh.p.k. pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, ky i fundit nuk gëzon më interes të ligjshëm në përputhje me pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi pozitat e këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi nuk do të ndryshonin.

III.4.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.4.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Giithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët se operatori për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për këtë operator të renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kronos Konstruksion” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “CURRI” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rikonstruksion dhe Instalim i Sistemit të ngrohjes në Shkollën e mesme ”Ismail Qemali”*”, me nr. REF-35140-11-21-2017, me fond limit 109,796,282 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.12.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1904 protokoli Datë 28.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha